



## Treguesit për vlerësimin e ndikimit të shërbimeve/produkteve të TI-së ndaj të drejtave të njeriut në proceset e prokurimit

Kur institucionet publike prokurojnë shërbime/produkte të TI-së, përfshirë sisteme algoritmike, ato duhet të sigurojnë mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut. Kjo përgjegjësi rrjedh nga detyrimet ndërkombëtare dhe/ose konstitucionale, shpesh e përkthyer në norma më të detajuara për të drejta specifike (p.sh., kur bëhet fjalë për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave ose të drejtën për mosdiskriminim) dhe në një të ardhme të afërt do të plotësohet me instrumente juridike shtesë, përfshirë Ligjin për inteligjencë artificiale të BE-së. Gjatë prokurimit të shërbimeve/produkteve të TI-së, institucionet publike duhet ta bëjnë të qartë se cilat vlera publike dhe parime demokratike duhet të ruhen dhe mbrohen dhe duhet të ekzistojë një pasqyrë e vërtetë e asaj nëse zgjidhja teknologjike është efektive dhe adekuate për zgjidhjen e një problemi të caktuar ose për ndjekjen e një politike të caktuar publike.

Vlerësimi i ndikimit ndaj të drejtave të njeriut luan rol kryesor në këtë pasqyrim dhe ato janë esenciale për sigurimin e besimit publik ndaj teknologjisë. Në mënyrë që të arrihet kjo, vlerësimi i ndikimit duhet të jetë praktikë e detyrueshme ku vlerat publike dhe implikimet e të drejtave të njeriut merren parasysh dhe maten në mënyrë adekuate dhe respektohen plotësisht. Pa marrë parasysh metodologjinë e miratuar, procesi i vlerësimit duhet doemos të jetë transparent, i përgjegjshëm, paritcipativ dhe i inkorporuar në kontekstin më të gjerë shoqëror mbi të cilin mund të ketë ndikim teknologjia.

Ky dokument ofron udhëzime për të kontrolluar nëse të dy institucionet publike që prokurojnë shërbime/produkte të TI-së, përfshirë sisteme të inteligjencës artificiale (IA) ose algoritmit, dhe nëse shitësit/zhvilluesit e tyre kanë vendosur mekanizma për vlerësim të ndikimit ndaj të drejtave të njeriut dhe për menaxhimin/zbutjen e rreziqeve të tyre nga dëmi.

Grupi i propozuar i treguesve ka për qëllim të ofrojë udhëzime për kërkesat minimale për një proces kuptimplotë të vlerësimit të ndikimit të inkorporuar në politikën e prokurimit. Në vend që të përshkruajmë një metodologji specifike për vlerësimet e ndikimit, ne propozojmë një kornizë për pyetjet e detajuara të hartuara për të siguruar dobi dhe përfitim maksimal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë prokurimit të teknologjisë. Në këtë mënyrë, institucioneve publike dhe zhvilluesve të TI-së u është ofruar fleksibilitet i mjaftueshëm për të formësuar dhe përshtatur procesin e vlerësimit në kontekste dhe situata specifike, njëkohësisht duke qenë në gjendje të verifikojnë nëse metodat e tyre janë mjaft të fuqishme për vlerësimin e saktë dhe zbutjen e ndikimeve ndaj të drejtave të njeriut.

Çdo tregues do të plotësohet nga lista e burimeve të dobishme, përfshirë metodologjitë dhe udhëzimet ekzistuese. Këto udhëzime do të shqyrtohen dhe finalizohen nga grupi ndërsektorial i punës për biznesin dhe të drejtat e njeriut ndërsa vazhdon të sigurojë forum ku sektori publik dhe privat bashkëpunojnë për të diskutuar zhvillimin e politikave dhe praktikave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Prandaj, qëllimi i këtyre udhëzimeve është të ndihmojë të gjithë palët e interesuara përkatëse, përkatësisht sektorin publik dhe privat, si dhe organizatat e shoqërisë civile për të identifikuar boshllëqet e mundshme në



rregulloret ekzistuese kombëtare të cilat ndoshta do të duhet të trajtohen, të miratohen praktikat më të mira dhe të zotohen ato për përfshirjen e treguesve për vlerësimin e ndikimit ndaj të drejtave të njeriut në Strategjinë e ardhshme kombëtare të IA-së.

TREGUESIT PËR VLERËSIMIN KUPTIMLOTË TË NDIKIMIT TË SHËRBIMEVE/PRODUKTEVE TË TI-së NDAJ TË DREJTAVE TË NJERIUT NË, PËRFSHIRË SISTEMET E IA-së		
<b>Treguesi 1: Korniza normative</b>		
<i>Ky tregues bën matjen nëse procesi i vlerësimit bazohet në standardet përkatëse juridike ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut. Qëllimi i tij është, gjithashtu, të sigurojë se fushëveprimi dhe përmbajtja e vlerësimit lejojnë identifikimin e saktë dhe zbutjen e ndikimeve negative ndaj të drejtave të njeriut, përfshirë situatat ku ndikimet negative ndaj të drejtave të njeriut janë në mënyrë të papranueshme të larta dhe të pamundur për zbutje</i>		
	<b>A i referohet kjo pyetje institucionit publik</b>	<b>A u referohet kjo pyetje shitësve/zhvilluese</b>
<p>1.1. A ekzistojnë politika dhe procedura për të vlerësuar ndikimet e mundshme negative të shërbimit/produktit të prokuruar ndaj të drejtave të njeriut?</p> <p>Procesi i prokurimit duhet doemos t'i ndjekë të gjitha ligjet përkatëse përveç ligjeve të prokurimit, duke përfshirë ligjin për mbrojtjen e të dhënave, i cili tashmë kërkon një vlerësim të ndikimit ndaj të drejtave themelore që rrjedhin nga përpunimi i të dhënave, dhe rregulloren e ardhshme të IA-së e cila ka gjasa t'i obligojë instaluesit e sistemeve të IA-së me rrezik të lartë të kryejnë vlerësim të ndikimit ndaj të drejtave përpara instalimit. Këto rregullore zbatohen drejtpërdrejt dhe këto kërkesa nuk duhet të përfshihen në mënyrë eksplicite në ligjin e prokurimit për të qenë të detyrueshme. Detajet e procesit të vlerësimit mund të zhvillohen brenda administratës</p>	PO	PO

<p>1.2. A ekzistojnë politika dhe procedura për të identifikuar se cilat individë dhe grupe janë prekur potencialisht nga shërbimi/produkti dhe qëllimi i tyre?</p> <p><i>Kjo pyetje është e rëndësishme sepse shërbimet/produktet e TI-së nuk do të ndikojnë domosdoshmërisht ndaj secilit ose mund të ndikojnë ndryshe ndaj grupeve të ndryshme të njerëzve. Vlerësimi duhet të realizohet në atë mënyrë që të jetë e qartë se të drejtat e kujt dhe në çfarë mënyrë ndikohen ose mund të ndikohen.</i></p> <p><i>Për shembull, si të identifikohen ato që janë prekur, konsultoheni me pjesën e DfVNA (FRAIA).</i></p>	<p>PO</p>	<p>PO</p>
<p>1.3. A ekzistojnë politika dhe procedura për të treguar vlerat publike dhe qëllimet demokratike që duhen ruajtur dhe mbrojtur në procesin e prokurimit? Cilat vlera publike dhe qëllime demokratike mund të pësojnë si rezultat i prokurimit të shërbimit/produktit të TI-së?</p> <p><i>Është e rëndësishme që këto të tregohen në mënyrë eksplicite, sesa të nënkuptohen. Kjo mund ta lehtësojë përgjegjësinë ndaj publikut, si dhe ta mbështesë vlerësimin e efektit të shërbimit/produktit të TI-së në faza më të vonshme.</i></p> <p><i>Për shembull, çfarë pyetje të parashtrohet, shih pjesën 1.3 të DfVNA (FRAIA).</i></p>	<p>PO</p>	<p>NUK KA PËRGJIGJE</p>
<p>1.4. A përfshijnë politikat dhe procedurat ekzistuese angazhim/konsultim të palëve të interesuara përkatëse (shoqëria civile, grupet e prekura) në faza të ndryshme?</p> <p><i>Kjo gjithashtu duhet të përfshijë angazhim në bisedim me palët e interesuara nëse përdorimi i teknologjisë së caktuar është i nevojshëm, dhe nëse po, si ndikon ndaj vlerave publike. Për pyetje më të hollësishme lidhur me angazhimin e palës së interesuar, shih Treguesi 4.</i></p>	<p>PO</p> <p>Angazhim nga përgatitja e hershme e kontratës së prokurimit gjatë gjithë fazës së implementimit të saj.</p>	<p>PO</p> <p>Angazhim nga faza e hershme e hartimit/zhvillimit gjatë gjithë fazës së përgjigjes ndaj tenderit</p>

<p>1.5. A ekzistojnë aktorë tjerë, përveç zhvilluesve të produktit/shërbimit, që kërkohet të përfshihen në çfarëdo fazë të procedurës së prokurimit (p.sh., organe tjera kombëtare, lokale, agjenci qeveritare)?</p> <p><i>Rekomandojmë që të siguroheni që organet publike përkatëse të kenë mundësi për të kontribuar në procesin e vlerësimit. Ekspertiza e tyre gjithashtu mund të jetë e dobishme për identifikim të saktë të ndikimeve, p.sh., në rastin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut ose organi për mbrojtjen e të dhënave.</i></p>	PO	NUK KA PËRGJIGJE
<p>1.6. Cilat instrumente juridike ndërkombëtare apo rajonale për të drejtat e njeriut konsiderohen si bazë apo kritere për harmonizim me të drejtat e njeriut?</p> <p><i>Edhe institucionet publike edhe zhvilluesit duhet të specifikojnë instrumente konkrete. Meqë Maqedonia e Veriut është anëtare e Këshillit të Evropës dhe kandidatë për anëtarësim në BE, rekomandojmë që t'i referoheni Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kartës për të Drejtat Themelore të BE-së.</i></p>	PO	PO
<p>1.7. A është trajnuar stafi përkatës mbi standardet për të drejtat e njeriut (jo vetëm etike) dhe zbatimin e tyre në kontekst të asaj se ku do të funksionojë sistemi?</p> <p>Përndryshe, a e sigurojnë ekspertizën për të drejtat e njeriut ekspertë të jashtëm, nëse stafi nuk ka ekspertizë të brendshme?</p>	<p>PO</p> <p><i>Koment:</i></p> <p><i>Veçanërisht për stafin e menaxhimit dhe prokurimit. Përkushtimi i vëmendjes shtesë ndaj vlerësimit, kujdesit dhe ruajtjes së ekspertizës dhe kompetencës institucionale për minimizim të nënkontraktimit dhe humbjes së kompetencës është kryesore për prokurimin e</i></p>	<p>PO</p> <p>Hartues/zhvillues/menaxhues</p>

	<i>teknologjisë në përputhje me të drejtat e njeriut.</i>	
<p>1.8. A është përkufizuar qartazi fushëveprimi i vlerësimit të ndikimit? P.sh., a e përfshin edhe qëllimin e destinuar dhe potencialisht të padestinuar të produktit/shërbimit?</p> <p>1.9. A siguron kjo vlerësimin e ndikimit ndaj të gjitha të drejtave relevante të njeriut?</p> <p><i>Meqë vlerësimi i rëndësishëm mund të jetë i gjatë, ndonjëherë mund të jetë e nevojshme të zgjidhen fillimisht të drejta specifike të njeriut për t'u vlerësuar. Në raste të tilla, rekomandojmë që t'u japim prioritet të drejtave të theksuara të njeriut, përkatësisht ato të drejta që kanë më shumë gjasa të ndikohen, ose ku ndikimet janë më të mëdha. Këto të drejta mund të përcaktohen në bazë të përvojave paraprake me shërbime/produkte të ngjashme të TI-së ose përmes konsultimeve me palët e interesuara të jashtme, p.sh., autoritetet publike ose shoqëritë civile përkatëse.</i></p>	PO	PO
<p>1.10. A përfshin politika e prokurimit klauzolën “nuk aprovohet (përkatësisht nëse rezultatet nga vlerësimi i ndikimit tregojnë se shërbimi/produkti është shumë i dëmshëm ose rreziku i dëmit nuk mund të menaxhohet apo zbutet, atëherë shërbimi/produkti duhet të mos zhvillohet, prokurohet dhe/ose përdoret)?</p> <p><i>Mundësia për të konkluduar se shërbimi/produkti i TI-së nuk është në përputhje me të drejtat e njeriut dhe si rrjedhojë nuk duhet të prokurohet, është kusht thelbësor për ta bërë procesin e vlerësimit kuptimplotë. Përndryshe, vlerësimi rrezikon të bëhet ushtrim për shënim të kutive. Në përgjithësi, ndikimet ndaj të drejtave të njeriut do të jenë të papranueshme atëherë kur e shkelin thelbin e të drejtës specifike ose dinjitetit të njeriut ose kur ashpërsia dhe probabiliteti i ndikimit janë të larta dhe nuk ekziston masë e saktë e zbutjes.</i></p>	PO	NUK KA PËRGJIGJE

**Treguesi 2: Procesi transparent dhe llogaridhënës i vlerësimit**

Treguesi bën matjen nëse vlerësimet e ndikimit janë transparente, të përgjegjshme dhe përsëritëse (të inkuorpuara në ciklin e jetës së produktit/shërbimit). Gjithashtu e mat nivelin e qartësisë në aspekt të ndarjes së roleve dhe përgjegjësiave ndërmjet institucioneve publike dhe shitësve dhe brenda stafit të të dyja palëve, në mënyrë për të parandaluar shpërndarjen e llogaridhënies. Përfundimisht, ky tregues mat nivelin e transparencës së prokurimit dhe procesit të vlerësimit të ndikimit, përfshirë informatën që duhet t'ia ofrojë shitësi/zhvilluesi institucionit publik.

**Fazat dhe shkaset e vlerësimit të ndikimit**

<p>2.1. A është bërë vlerësimi i ndikimit mjaft herët në ciklin e jetës së shërbimit/produktit për të ndikuar në dizajnimin, zhvillimin dhe testimin/pilotimin?</p> <p><i>Për të qenë vlerësimi kuptimplotë, rezultatet e tij duhet të jenë në gjendje të informojnë dizajnimin final të shërbimit/produktit të TI-së, p.sh., përfshirja e masave specifike të zbutjes. Shih pyetje më të hollësishme 2.3.</i></p>	<p><b>PO</b></p> <p><i>Kjo vlen kur institucioni prokuron zhvillimin e shërbimit/produktit (sesa produktit të gatshëm). Sidoqoftë, edhe kur prokurohet produkti përfundimtar, nuk ekzistojnë pengesa për thirrjen për tender që të kërkojë nga shitësit që dëshirojnë të paraqesin ofertë të sigurojnë dokumentacion se vlerësimi i tillë i ndikimit tashmë është realizuar (shih pyetja 2.3.1).</i></p>	<p><b>PO</b></p>
<p>2.2. A ofron politika e prokurimit mekanizëm shtytës për të përsëritur vlerësimin e ndikimit gjatë gjithë ciklit të jetës së shërbimit/produktit (jo para përdorimit të tij)? A është e qartë në aspekt të asaj se janë këto faza dhe kush janë aktorët përgjegjës për vlerësimin?</p>	<p><b>PO</b></p> <p><i>Është e rëndësishme të qartësohet në thirrjen për tender ose në kontratën e prokurimit se çfarë roli duhet të kenë shitësit pas prokurimit të shërbimit/produktit, p.sh., nëse</i></p>	<p><b>PO</b></p>

	<i>duhet të asistojë organi publik në përsëritjet e ardhshme të vlerësimit.</i>	
<p><b>Rolet dhe përgjegjësitë</b></p> <p><i>Besimi publik në përdorimin e teknologjive kërkon që rolet lidhur me vlerësimin e ndikimit të sistemit të ndahen apo caktohen qartazi. Megjithëse, fundja është përgjegjësi e institucionit publik për të siguruar përputhshmëri të shërbimit/produktit me të drejtat e njeriut, procesi i prokurimit duhet të dizajnohet në atë mënyrë që të sigurojë që shitësit t'i asistojnë aktivisht institucionet në këtë proces ose të marrin përsipër një pjesë të përgjegjësisë për t'i lehtësuar obligimet për analizë të thellë të institucionit.</i></p>		
<p>2.3. A ekziston qartësi lidhur me atë se kush është përgjegjës për vlerësimin e ndikimit përpara vendosjes së shërbimit/produktit?</p> <p><i>Dy skenarë:</i></p> <p>2.3.1.</p> <p>Nëse institucioni kërkon që të prokurojë mjet përfundimtar, a duhet që shitësi të sigurojë vlerësim të ndikimit të mjetit përfundimtar për rishikim, auditim dhe ku nevojitet plotësim nga institucioni publik?</p> <p>2.3.2. Nëse institucioni kërkon që të prokurojë zhvillimin e mjetit nën mbikëqyrjen e tij, a duhet që shitësi të bashkëpunojë me dhe të asistojë institucionin në realizimin e vlerësimit të ndikimit?</p>	PO	PO
<p>2.4. A është e qartë se kush duhet të përfshihet brenda ekipit të vlerësimit, nga rolet e përfshirë në dizajnimin, zhvillimin dhe testimin e shërbimit/produktit?</p> <p><i>Vlerësimi nuk mund të bëhet tërësisht nga tjerë përveç atyre të përfshirë në zhvillimin ose vendosjen e shërbimit/produktit. Kushdo që e udhëheq vlerësimin, duhet të veprojë kështu në konsultim të drejtpërdrejtë dhe të</i></p>	PO	PO

<p><i>afërt me ekipin që e zhvillon shërbimin/produktin. Me fjalë të tjera, vlerësimi duhet doemos të pranohet nga të gjithë njerëzit e përfshirë si një element i rëndësishëm i gjithë procesit zhvillimor.</i></p>		
<p>2.5. A duhet që vlerësuesit (ose një pjesë e ekipit më të madh të vlerësimit) të kenë ekspertizë mbi të drejtat e njeriut?</p> <p>2.5.1. A e kanë të garantuar pavarësinë gjatë realizimit të vlerësimit?</p> <p><i>Pavarësia në këtë kontekst do të thotë se vlerësuesit nuk mund të ndiejnë kurrfarë presioni lidhur me realizimin e vlerësimit. Atyre gjithashtu duhet t'u garantohen resurse financiare dhe resurse tjera për ta kryer punën e tyre siç duhet. Ky presion i panevojshëm mund të jetë politik (p.sh., që vjen nga ndonjë ministër), financiar ose bazuar në vartësinë e punonjësit (p.sh., që merr urdhra nga mbikëqyrësi). Mund të nxirret frymëzim nga ajo se si pozita e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave është përcaktuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>
<p>2.6. A janë të përfshira në fazat e ndryshme të vlerësimit të sistemit grupet kryesore ose komunitetet e prekura potencialisht nga sistemi?</p> <p><i>Për pyetje më të hollësishme lidhur me angazhimin e palëve të interesuar, shih Treguesi 4.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>
<p><b>Kërkesat për dokumentim dhe zbulim</b></p>		
<p>2.7. A ekziston kërkesë për dokumentim në detaje të procesit të vlerësimit të ndikimit, metodologjisë dhe rezultateve të tij?</p> <p><i>Kjo vlen edhe për vlerësimin e ndikimit të realizuar nga institucioni publik para vendosjes së shërbimit/produktit edhe për vlerësimin e ndikimit të</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>



<p><i>realizuar nga shitësit/zhvilluesit që ofrojnë produkt përfundimtar në thirrjen për tenderë.</i></p>		
<p>2.8. A është e detyrueshme që të publikohen rezultatet e vlerësimit të ndikimit pas finalizimit?</p> <p><i>Rekomandojmë fuqimisht të siguroheni që së paku përmbledhja e rezultateve të jetë e disponueshme publikisht, së bashku me informatat kryesore për shërbimin/produktin e TI-së. Kjo është e nevojshme për shqyrtimin publik dhe llogaridhënien.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>NUK KA PËRGJIGJE</b></p>
<p>2.9. A kërkohet që shitësit t'ua japin informatat institucioneve publike për shërbimin/produktin që do t'u mundësojë institucioneve publike të sigurojnë proces të duhur për njerëzit e prekur nga sistemi dhe t'i tregojnë publikut se shërbimi/produkti punon në mënyrë të rregullt, të drejtë dhe në përputhje me të drejtat e njeriut dhe ligjet përkatëse?</p> <p>2.9.1. Për sistemet algoritmike/IA, a e përfshin kjo informatë: qëllimin e algoritmit, informatën e cila siguron që sistemi funksionon në mënyrë të rregullt dhe prodhon rezultate të verifikuara (p.sh., protokollet dhe rezultatet e verifikimit, treguesit e performancës), informatën e nevojshme për t'ua ofruar njerëzve të prekur nga sistemi i IA-së të dhënat e tyre specifike që përdoren nga sistemi, informatën për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të nevojshme për përmbushjen e kërkesave RPMDH (rezultate nga vlerësimi i ndikimit ndaj mbrojtjes së të dhënave, burime të të dhënave për trajnim/verifikim dhe baza ligjore për mbledhje, informata për llojet e të dhënave personale të përdorura nga sistemi, qëllimet, koha e ruajtjes, që ka qasje në të dhënat personale, si ruhen dhe si sigurohen të dhënat, etj).</p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>



<p><i>Shitësit privatë mund të jenë të prirë për rritje të sekreteve të tyre të tregtare ose mbrojtjes së të drejtave autoriale si një arsye për të mos i ndarë informatat e caktuara me autoritetin që e prokuron shërbimin/produktin e TI-së. Për llogaridhënie publike për shërbimet ose produktet që do t'i prekin qytetarët dhe për të siguruar proces të duhur për njerëzit e prekur, është me rëndësi që organi të sigurojë qasje në të gjitha informatat përkatëse. Është në kuadër të kompetencës së organit për ta formësuar thirrjen për tenderë në atë mënyrë që do të lejojë vetëm ato oferta që do të garantojnë nivel të mjaftueshëm të transparencës.</i></p>		
<p>2.10. A kërkohet nga shitësit që të heqin dorë nga çfarëdo pretendimi për privilegjin e sekretit tregtar lidhur me llojet e informatave të cilat institucionet publike duhet t'ia paraqesin publikut se shërbimi/prodakti (përfshirë sistemet algoritmike) janë të dizajnuara mirë dhe të drejta?</p> <p><i>Vini re se për disa lloje të informatave shumë të rëndësishme, p.sh., qëllimi i sistemit, rezultatet e verifikimit, treguesit e performancës, kompanitë ka gjasa të mos mund të pretendojnë sekrete tregtare (sepse këto parametra tregojnë se sistemi është duke funksionuar mirë, në vend që të ketë vlerë komerciale).</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>
<p><b>Treguesi 3. Metodologjia e vlerësimit të ndikimit</b></p> <p><i>Ky tregues mat nëse metodologjia e vlerësimit të ndikimit ndaj të drejtave të njeriut nuk është vetëm ushtrim për shënim të kutive por garanton një pasqyrim kuptimplotë dhe llogaridhënës të ndikimit të shërbimit/prodaktit. Ju lutemi kini parasysh se tashmë ekzistojnë disa metodologji të propozuara. Kjo pjesë nuk imponon metodë specifike për vlerësim por përfshin një listë të pyetjeve për vlerësim nëse metodologjia e përzgjedhur është mjaft e fuqishme, efektive dhe e saktë për të siguruar përputhshmëri me të drejtat e njeriut.</i></p>		



**Burime relevante për metodologjitë e vlerësimit të ndikimit:**

- [Të drejtat themelore dhe vlerësimi i ndikimit algoritmik \(FRAIA\) të Holandës](#)
- Instituti për të Drejtat e Njeriut i Danimarkës: [Udhëzimi për të vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve digjitale ndaj të drejtave të njeriut](#)
- Fondacioni Moje Państwo: [Vlerësimi i ndikimit algoritmik të sistemit IA/ADM – Propozim për sektorin publik](#)
- A. Mantelero: [Përtej të dhënave: Të drejtat e njeriut, vlerësimi i ndikimit etik dhe shoqëror në AI](#)
- A. Mantelero dhe S. Esposito. [“Metodologjia e bazuar në prova për vlerësimin e ndikimit të drejtave të njeriut \(HRIA\) në zhvillimin e sistemeve për të dhëna intensive të IA”](#) Ligji i kompjuterit dhe Studimi i sigurisë “Computer Law & Security Review” (2021)
- ECNL dhe Të dhënat dhe Shoqëria: [Rekomandime për inkorporimin e të drejtave të njeriut në vlerësimet e ndikimit të IA-së](#)
- ECNL: [Vlerësimi i riskut të sistemeve të IA-së ndaj të drejtave të njeriut nga qasja e bazuar në nivele](#)
- Qasu tani: [Vlerësimet e ndikimit ndaj të drejtave të njeriut për IA: Analiza dhe rekomandime](#)

3.1. A ekzistojnë tregues të qartë për vlerësimin e ndikimit negativ (aktual dhe potencial) të bazuar në standardet e të drejtave të njeriut të identifikuar si kritere në Pyetjen 1.6?	PO	PO
3.2. A janë të përfshirë në vlerësimin e ndikimit përdorimi i destinuar dhe përdorimet (keqpërdorimi) potenciale të padestinuara të shërbimit/produktit?	PO	PO
3.3. A ekzistojnë metrika dhe shkallë të qarta për vlerësimin e gjasës dhe ashpërsisë së çdo ndikimi potencial në kontekste të ndryshme dhe nivele të ndryshme të ekspozimit të bartësve të të drejtave të prekur potencialisht?  <i>Për udhëzim, shih A. Montelero dhe S. Esposito. “Metodologjia e bazuar në prova për vlerësimin e ndikimit ndaj të drejtave të njeriut (HRIA) në zhvillimin e sistemeve për të dhëna intensive të AI-së. “. Ligji i kompjuterit dhe Studimi i sigurisë (2021)</i>	PO	PO
3.4. A përfshin metodologjia për vlerësimin e ndikimit identifikim të nivelit të riskut (p.sh., i ulët, i mesëm, i lartë, shumë i lartë, i	PO	PO



<p>papranueshëm) për të gjitha të drejtat përkatëse të njerikut në kontekste të ndryshme dhe për bartës të ndryshëm të të drejtave potencialisht të prekur?</p> <p><i>Për frymëzim, ju lutem konsultoni <a href="#">Punimi i ECNL-së për vlerësimin e sistemeve të IA-së dhe Punimi Qasu Tani</a>.</i></p>		
<p>3.5. A ekziston kërkesë për vendosje të balancës proporcionale ndërmjet riskut dhe ndikimit negativ potencial të shërbimit/produktit dhe përfitimeve për çdo të drejtë të prekur potencialisht, përfshirë arsyetimin e çdo vendimi?</p> <p><i>Për frymëzim, shih pjesën 4.7 e DTHVNA-së</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>
<p>3.6. A ekziston kërkesë për identifikim dhe përshkrim të masave specifike për shmangie dhe zbutje të riskut?</p> <p>3.6.1. A ekziston opsion për të konkluduar se nuk ekzistojnë masa për shmangie ose zbutje të riskut të papranueshëm?</p> <p><i>Për udhëzim për masat e zbutjes, shih <a href="#">Aneksi 2 i DTHVNA</a>.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>
<p>3.7. Nëse vlerësimi tregon se nuk ekzistojnë masa adekuate për shmangie ose zbutje të riskut të papranueshëm, a rezulton në ndërprerjen e zhvillimit ose vendosjes së produktit/servisit?</p> <p><i>Mundësia për të konkluduar se shërbimi/produkti i TI-së nuk është në përputhje me të drejtat e njeriut dhe si rrjedhojë nuk duhet të prokurohet është kusht thelbësor për ta bërë procesin e vlerësimit të rëndësishëm. Përndryshe, vlerësimi rrezikon të bëhet ushtrim i shënimit të kutive. Në përgjithësi, ndikimi ndaj të drejtave të njeriut do të jetë i papranueshëm</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>

<p><i>kur e cenon esencën e të drejtës specifike ose dinjitetit të njeriut ose kur ashpërsia ose probabiliteti i ndikimit janë të lartë dhe kur nuk ekzistojnë masa të sakta për zbutje.</i></p>		
<p><b>Treguesi 4: Angazhimi kuptimplotë i palës së interesuar</b></p> <p><i>Ky tregues mat nëse palët e interesuara të jashtme përkatëse (individë dhe grupe të prekura, organizatat e shoqërisë civile, sindikatat, institutet kombëtare për të drejtat e njeriut, shoqatat e industrisë, ekspertët e të drejtave të njeriut, ekspertët akademikë etj) janë angazhuar në bisedimin lidhur me ndikimet potenciale ose aktuale të shërbimit/produktit. Angazhimi i tillë është esencial për identifikim të saktë të riskut dhe masave për zbutje, si dhe për ndërtimin e besimit publik ndaj teknologjisë.</i></p> <p><b>Burimet relevante:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ECNL: <a href="#">Korniza për angazhim kuptimplotë të palëve të interesuara në vlerësimin e ndikimit të IA-së</a></li> <li>• Instituti për të drejtat e njeriut i Danimarkës: <a href="#">Angazhimi i palëve të interesuara në vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve digjitale ndaj të drejtave të njeriut</a></li> </ul>		
<p>4.1. A është i detyrueshëm konsultimi kuptimplotë i palëve të interesuara të jashtme gjatë procesit të vlerësimit dhe përsëritjeve të tij?</p> <p><i>Gjatë përsëritjeve të vlerësimit (p.shs., shqyrtim vjetor) nuk është e nevojshme të realizohet i gjithë procesi i konsultimit nga fillimi. Organi ose kompania duhet të vlerësojnë se çfarë është e arsyeshme, p.sh., nëse duhet të konsultohen palët e interesuara të përzgjedhura, ose të kufizohet konsultimi në çështje të reja.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p> <p><i>Në fazë dizajnimi, zhvillimi dhe testimi.</i></p>
<p>4.2. A kërkohet që shitësi të asistojë institucionin publik në konsultime publike dhe në angazhimin e palëve të interesuara?</p> <p><i>Asistimi i tillë mund të jetë kërkesë eksplicite në thirrjen për tenderë/kontrata prokurimi. Kjo mund të jetë një zgjidhje e mirë për</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>

<p><i>nënkontraktim të procesit nëse organi nuk ka resurse të mjaftueshme njerëzore.</i></p>		
<p>4.3. A ekzistojnë metoda/modele të sugjeruara për konsultim kuptimplotë dhe angazhim të palëve të interesuara të jashtme?</p> <p>4.3.1. Me fjalë të tjera, si të identifikojmë grupe kryesore ose komunitete të prekura potencialisht nga shërbimi/prodkti, përfshirë gjatë zhvillimit të tyre? Dhe si të identifikojmë palë tjerë të interesuara të cilët duhet të përfshihen në faza të ndryshme (p.sh., shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare, institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, ekspertë, shoqata të industrisë, gazetarë, etj)?</p> <p><i>Për këshilla, konsultoni Kornizën për angazhim kuptimplotë.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p> <p><i>Në fazë dizajnimi, zhvillimi dhe testimi.</i></p>
<p>4.4. A kanë mundësi palët e interesuara të jashtme të ofrojnë informatë dhe koment mbi gjetjet/rezultatet e vlerësimit të ndikimit para se të bëhet funksional shërbimi/prodkti?</p> <p><i>Qëllimi i angazhimit është të kuptojë këndvështrimin e palëve të interesuara me qëllim të përmirësimit të shërbimit/prodktit dhe kufizimit të ndikimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut. Mundësia për të kontribuar përpara vendosjes e bën procesin e konsultimit kuptimplotë.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p> <p><i>Në fazë dizajnimi, zhvillimi dhe testimi.</i></p>
<p>4.5. A ekziston obligim për t'u dhënë informatë kthyesë palëve të interesuara të jashtme për kontributin e tyre dhe të sqarohet nëse dhe si është inkorporuar në rezultatet ose jo (dhe pse)?</p> <p><i>Nëse konsultimi bazohet në dialogun dhe informatën kthyesë, palët e interesuara do të binden se ia vlen të angazhohen.</i></p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p> <p><i>Në fazë dizajnimi, zhvillimi dhe testimi.</i></p>
<p>4.6. A ekziston obligim për të dokumentuar angazhimin e palëve të interesuara gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit?</p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>PO</b></p>

4.6.2. Si? A është kjo informatë publike? Ku dhe nëse jo, pse?		<i>Në fazë dizajnimi, zhvillimi dhe testimi.</i>
<p><b>Treguesi 5. Mbikëqyrja dhe monitorimi efektiv</b></p> <p><i>Ky tregues mat nëse vlerësimi i ndikimit është llogaridhënës ndaj mbikëqyrësve/auditorëve të jashtëm si dhe nëse është objekt i shqyrtimit publik. Qëllimi i këtij treguesi është të garantojë kornizë institucionale për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm në rast se ndryshon konteksti dhe në rast se lindin ndikime të reja.</i></p>		
<p>5.1. A ekziston kërkesa e qartë për dokumentim të procesit dhe gjetjeve të vlerësimit të ndikimit?</p> <p><i>Kjo pyetje është e njëjtë si pyetja 2.7 por përsëritet këtu pasi kërkesat e dokumentacionit në Indikatorin 2 shërbejnë për transparencë ndërmjet palëve të prokurimit dhe ky tregues ka për qëllim të sigurojë transparencë ndaj palëve të jashtme të interesuara dhe organeve mbikëqyrëse.</i></p>	PO	PO
5.2. A përshkruan raporti final si ka ndikuar vlerësimi i ndikimit ndaj dizajnit, zhvillimit dhe vendosjes së shërbimit/produktit?	PO	PO
5.3. A ekziston mbikëqyrje dhe shqyrtim ose auditim i jashtëm i detyrueshëm i gjetjeve të vlerësimit të ndikimit?	PO	NUK KA PËRGJIGJE
5.4. A ekziston mundësia që njerëzit ose grupet e prekura dhe organizatat me interes publik t'i kontestojnë gjetjet e vlerësimit të ndikimit?	PO	NUK KA PËRGJIGJE
5.5. A duhet të publikohen gjetjet e vlerësimit të ndikimit dhe nëse po, rezultatet e plota apo përmbledhja e gjetjeve kryesore? Ku?	PO	NUK KA PËRGJIGJE

<p>(P.sh., a ekziston bazë e të dhënave e aksesueshme online e disponueshme për publikun me gjetjet për shërbimet/produktet e prokuruar/zhvilluar për sektorin publik?)</p> <p><i>Kjo është e njëjtë si Pyetja 2.8 por përsëritet për të theksuar rëndësinë e publikimit në mënyrë e cila është e aksesueshme për palët e jashtme të interesuara.</i></p>		
<b>Evaluimi i procesit të vlerësimit të ndikimit</b>		
<p>5.6. A ekziston procedurë për evaluimin e dizajnit të procesit të vlerësimit të ndikimit në dritën e treguesve të mësipërm? Kush është përgjegjës për këtë evaluim?</p>	<p><b>PO</b></p>	<p><b>NUK KA PËRGJIGJE</b></p>
<p>5.7. A shqyrtohet periodikisht dizajni i procesit të vlerësimit të ndikimit?</p>		